

SHOQËRIA "TRIOS" SH.P. K, NIPT: L12805203J
RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR DHE PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR
MË 31 DHJETOR 2019

*[Adresa: Rruga Dibrës, 462/2, Pranë Xhamisë Xhura, Porcelan, Kati I Dytë Tiranë,
Shqipëri]*



RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR	ii
I. Pasqyra e pozicionit financiar	1
II. Pasqyra e Performancës (sipas natyrës), [të ardhura dhe shpenzime]	3
III. Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin e vet	4
V. Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare.....	6
I. Informacion i përgjithshëm	6
A. Parimet bazë për përgatitjen e pasqyrave financiare.....	6
B. Politikat kryesore kontabile	7
1. Transaksionet në monedhë të huaj	8
2. Instrumentat financiare.....	8
3. Aktivet Afagjate Materiale (AAM) dhe Jo materiale (AAJM).....	10
4. Të ardhurat.....	11
5. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit.....	11
6. Qiratë	11
7. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare.....	12
8. Tatimi mbi fitimin	12
9. Fondet për pensione	12
10. Transaksionet me palët e lidhura	12
11. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara	12
12. Krahasueshmeria e informacionit kontabel	12
13. Mjetet Monetare	13
14. Llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme.....	13
15. Inventare	13
16. Shpenzime të shtyra.....	13
17. Aktive Afatgjata Materiale	13
18. Detyrime ndaj institucioneve te kredise.....	13
19. Detyrime Afatshkurtra.....	14
20. Struktura e kapitalit.....	14
21. Të ardhura nga veprimtaria e shfrytëzimit.....	14
22. Lenda e pare dhe materiale të konsumueshme.....	14
23. Shpenzime të personelit	14
24. Shpenzime konsumi dhe amortizimi	14
25. Shpenzime te tjera nga veprimtari e shfrytezimit	15
26. Shpenzime & ardhurat financiare	16
27. Rezultati Tatimor dhe Fitimi /(humbja) i vitit ushtrimor	16
28. Palët e lidhura	16
29. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara	16



I. Pasqyra e pozicionit financiar

Shënime	Date: 31.12.2019	Date: 31.12.2018	
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	13	1,946,101	11,538,525
Investime		-	-
<i>Ne tituj pronësie të njesive ekonomike brenda grupit*</i>		-	-
<i>Ne tituj pronësie të njesive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>		-	-
<i>aksione të veta</i>		-	-
<i>Te tjera financiare</i>		-	-
Te drejta të arketueshme		-	-
<i>Nga aktiviteti i shfrytëzimit</i>	14	96,272,725	61,783,960
<i>Nga njesite ekonomike brenda grupit*</i>		-	-
<i>Nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>		-	-
<i>Te tjera</i>	14	-	4,558,963
<i>Kapital i nënshkruar i papaguar</i>		-	-
Inventaret		-	-
<i>Lende e pare dhe materiale të konsumueshme</i>		-	-
<i>Prodhime në proces dhe gjysemprodukte</i>		-	-
<i>Produkte të gatshme</i>		-	-
<i>Mallra</i>	15	19,467,602	31,603,534
<i>Aktive biologjike (gje e gjalle në rritje dhe majmeri)</i>		-	-
<i>AAGJM të mbajtura për shitje</i>		-	-
<i>Parapagime për inventar</i>	15	2,150,000	2,150,000
Shpenzime të shtyra	16	-	2,708,829
Te arketueshme nga të ardhura të konstatuara		-	-
Totali i aktiveve afatshkurtra		119,836,428	114,343,812
Aktive afatgjate			
Aktive financiare			
<i>Tituj pronësie të njesive ekonomike brenda grupit*</i>		-	-
<i>Tituj pronësie të njesive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>		-	-
<i>Tituj të huadhenies në njesite ekonomike brenda grupit*</i>		-	-
<i>Tituj të huadhenies në njesite ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse AGJ</i>		-	-
<i>Tituj të tjere të mbajtur si aktive afatgjate</i>		-	-
<i>Tituj të tjere të huadhenies</i>		-	-
Aktive materiale		-	-
<i>Taka dhe ndertesa</i>	17	12,926,605	12,926,605
<i>Impiante dhe makineri</i>	17	93,436,994	87,397,135
<i>Te tjera instalime dhe pajisje</i>	17	1,066,985	1,395,868
<i>AAGJM të mbajtura për investim</i>		-	-
<i>Parapagime për aktive materiale dhe në proces</i>		-	-
Aktivitet biologjike		-	-
Aktive jo materiale		-	-
<i>Koncensionë, patenta, licenca, makra tregtare, të drejta dhe aktive të ngjashme</i>		-	-
<i>Emri i mire</i>		-	-
<i>Parapagime për AAJM</i>		-	-
Aktivitet tatimore të shtyra		-	-
Totali i aktiveve afatgjate		107,430,584	101,719,608
TOTALI I AKTIVEVE		227,267,012	216,063,420

Hartues i Pasqyrave Financiare

Ermir Veipi



Administrator

Edojar Sala



DETYRIMET DHE KAPITALI

	Shënime	Date: 31.12.2019	Date: 31.12.2018
Detyrime afatshkurtra			
<i>Titujt e huamarrjes</i>		-	-
<i>Detyrime ndaj institucioneve te kredise</i>	18	1.267.239	-
<i>Aktelime ne avance per parasi</i>	19	14.844.714	20.631.188
<i>Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit</i>	19	67.540.036	92.002.010
<i>Deftesa te pagueshme</i>		-	-
<i>Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit *</i>		-	-
<i>Te pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa pjesmarrese</i>		-	-
<i>Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shendetsore</i>	19	899.391	898.467
<i>Te pagueshme per detyrime tatimore</i>	19	271.480	929.348
<i>Te tjera te pagueshme</i>	19	93.123.645	54.050.387
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara		-	-
Te ardhura te shtyra		-	-
Provizione		-	-
Totali i detyrimeve afatshkurtra		177.946.504	168.511.400
Detyrime afatgjata			
<i>Titujt e huamarrjes AGJ</i>		-	-
<i>Detyrime ndaj institucioneve te kredise AGJ</i>	18	3.935.634	-
<i>Aktelime ne avance per parasi AGJ</i>		-	-
<i>Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit AGJ</i>		-	-
<i>Deftesa te pagueshme</i>		-	-
<i>Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit *</i>		-	-
<i>Te pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa pjesmarrese</i>		-	-
<i>Te tjera te pagueshme AGJ</i>		-	-
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara		-	-
Te ardhura te shtyra		-	-
Provizione		-	-
<i>Provizione per pensione</i>		-	-
<i>Provizione te tjera</i>		-	-
Detyrime tatimore te shtyra		-	-
Totali i detyrimeve afatgjata		3.935.634	-
Detyrime totale		181.882.138	168.511.400
Kapitali dhe Rezervat			
Kapitali i nenshkruar	20	15.000.000	13.350.000
Primi i lidhur me kapitalin	20	-	-
Rezerva rivleresimi	20	-	-
Rezerva te tjera	20	-	-
<i>Rezerva ligjore</i>	20	1.018.982	1.018.982
<i>Rezerva statutare</i>	20	-	-
<i>Rezerva te tjera</i>	20	20.725.718	22.697.526
<i>Diferenca nga perkthimi i monedhes ne veprimtari te huaja</i>	20	-	-
Fitimi/(humbja) e pashperndare	20	-	-
Fitimi/(humbja) e periudhes	27	8.640.173	10.485.512
Totali i kapitalit qe i takon pronareve njesise ekonomike		45.384.873	47.552.020
Interesa jo-kontrollues		-	-
Totali i kapitalit		45.384.873	47.552.020
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		227.267.011	216.063.420

Hartues i Pasqyrave Financiare

Ermir Veipi



Administrator

Edi Sula

Tiranë, më 23/10/2020



II. Pasqyra e Performancës (sipas natyrës), [të ardhura dhe shpenzime]

Shënime	Date: 31.12.2019	Date: 31.12.2018
Pasqyra e Performances (sipas natyres)		
Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit		
Te ardhurat nga aktiviteti kryesor	21 271,468,330	242,254,397
Te ardhurat nga aktiviteti dytesor 1	-	-
Te ardhurat nga aktiviteti dytesor 2	-	-
Te ardhurat nga aktiviteti dytesor 3	-	-
Te tjera te ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	21 761,476	1,787,023
Te ardhura nga ndryshimi ne inventarin e mallrave dhe prodhimit ne proces	-	-
Te ardhura nga puna e kryer nga njesia ekonomike per qellimet e veta dhe e kapitalizuar	-	-
Te ardhura te tjera te shfrytëzimit	-	-
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme	22	
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme	(237,214,909)	(231,273,829)
Te tjera shpenzime	-	-
Shpenzime te personelit		
Paga dhe shperblime	23 (6,277,600)	(5,894,300)
Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetesore	(924,122)	(825,420)
Shpenzimet per pensionet	-	-
Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	24 (6,500,511)	(779,506)
Shpenzime te tjera shfrytëzimi	25 (10,918,344)	(2,333,545)
Te ardhura te tjera	-	-
Te ardhura nga njesite ekonomike brenda grupit*	-	-
Te ardhura nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesmarrese	-	-
Te ardhura nga investimet dhe huate e tjera ne njesi ekonomike brenda grupit, pjese e aktiveve afatgjata *	-	-
Te ardhura nga investimet dhe huate e tjera ne njesi ekonomike ku ka interesa pjesmarrese, pjese e aktiveve afatgjata	-	-
Interesa te arketueshem dhe te ardhura te tjera te ngjashme nga njesi ekonomike brenda grupit *	-	-
Interesa te arketueshem dhe te ardhura te tjera te ngjashme nga njesi ekonomike ku ka interesa pjesmarrese	-	-
Zhvleresim i aktiveve financiare dhe investimeve financiare te mbajtura si aktive afatshkurtra	-	-
Shpenzime financiare		
Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme	26 (229,410)	-
Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme per tu paguar tek njesite ekonomike brenda grupit *	-	-
Shpenzime te tjera financiare	-	9,401,077
Pjesa e fitimit/(humbjes) financiare nga pjesmarrjet	-	0
Fitimi/(humbja) para tatimit	27 10,164,910	12,335,897
Tatimi mbi fitimin		
Tatimi mbi fitimin e periudhes	(1,524,737)	(1,850,384)
Tatim fitimi i shtyre	-	-
Pjesa e tatim fitimit te pjesemarrjeve	-	-
Fitimi/(Humbja) e periudhes/vitit (A)	27 8,640,174	10,485,512
<hr/>		
Te ardhura te tjera gjithepershireshe per periudhen/vitin:		
Totali i te ardhurave te tjera gjithepershireshe per periudhen/vitin (B)		
Totali i te ardhurave gjithepershireshe per periudhen/vitin (A+B)	8,640,174	10,485,512

Hartues i Pasqyrave Financiare

Ermir Veipi

ERMIR VEIPI
Auditor Ligjor
K81506022D

Administrator

Klodjan Sula

Tiranë, më 23/10/2020

III. Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin e vet

	Kapitali i nëshkruar	Primi i lidhur me kapitalin	Rezerva rivlerësimi	Rezerva Ligjore	Rezerva Statutare	Rezerva të tjera	Filimet e Pospërndara	Film / Humbja e vilit	19 20
13.330.000	13.330.000	1.018.982	18.997.352	3.699.968	37.066.302				
13.330.000	13.330.000	1.018.982	18.997.352	3.699.968	37.066.302				
Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse të periudhës:									
Film/(humbja) e perudhës									
Te ardhura të tjera gjithëpërfshirëse									
Tatime aktuale dhe të shtyrë të njëjtura drejtpërdrejt në kapital									
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse për te njëjtura drejt në kapital:									
Emetimi i kapitalit të nëshkruar									
Dividende të shpërndara									
Perçiktime të tjera për rezultatit e perudhës									
Totali i transaksioneve për pronat e njëjta ekonomike									
13.330.000	1.018.982	22.697.320	10.485.512	47.551.814					
Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse të periudhës:									
Film/(humbja) e perudhës									
Te ardhura të tjera gjithëpërfshirëse									
Tatime aktuale dhe të shtyrë të njëjtura drejtpërdrejt në kapital									
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse për Transaksione për pronat e njëjta ekonomike te njëjtura direkt në kapital:									
Emetimi i kapitalit të nëshkruar									
Dividende të shpërndara									
Perçiktime të tjera për rezultatit e perudhës (përshtatje)									
Totali i transaksioneve për pronat e njëjta ekonomike									
15.000.000	1.018.982	10.240.000	19.125.686	45.384.668					

Hartues i Pasqyrave Financiare & shënime të lidhura
ERMIR VEIPI
Auditor Ligjor
K81506022D

Administrator
Klodjan Sula



IV. Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare (metoda indirekte)

	Date: 31.12.2019	Date: 31.12.2018
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		
<i>Fitim / Humbja e vitit</i>	10,164,910	12,335,896
<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>		
<i>Shpenzimet financiare jomonetare</i>		
<i>Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar</i>	(1,524,737)	(1,850,384)
<i>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</i>	6,500,511	779,506
<i>Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale</i>		
<i>Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:</i>		
<i>Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>		
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>		
<i>Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera</i>	(29,929,801)	15,557,980
<i>Rënie/(rritje) në inventarë</i>	14,844,761	(25,661,351)
<i>Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme</i>	8,167,865	19,097,577
<i>Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit</i>		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	8,223,510	20,259,224
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
<i>Para neto të përdorura për blerjen e filialeve</i>	-	-
<i>Para neto të arkëtuara nga shitja e filialeve</i>	-	-
<i>Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale</i>	(12,211,487)	(9,105,783)
<i>Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>	-	-
<i>Pagesa për blerjen e investimeve të tjera</i>	-	-
<i>Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera</i>	-	-
<i>Dividentë të arkëtuara</i>	-	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(12,211,487)	(9,105,783)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
<i>Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar</i>	1,650,000	-
<i>Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral</i>	-	-
<i>Hua të arkëtuara</i>	-	-
<i>Pagesa e kostave të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë</i>	-	-
<i>Riblerje e aksioneve të veta</i>	-	-
<i>Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral</i>	-	-
<i>Pagesa e huave</i>	-	-
<i>Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare</i>	5,202,873	-
<i>Interes i paguar</i>	-	-
<i>Dividendë të paguar</i>	(12,457,320)	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(5,604,447)	-
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(9,592,424)	11,153,441
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	11,538,525	385,084
<i>Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	-	-
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	1,946,101	11,538,525

Hartues i Pasqyrave Financiare

Ermir Veipi
Ermir Veipi


Administrator

Klodjan Suta
Klodjan Suta


V. Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare

I. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria tregtare "Trios" sh.a, është themeluar si një shoqëri aksionare më 05 Prill 2011 dhe vepron në përputhje me ligjin "Për tregtarë dhe shoqëritë tregtare" dhe ligjeve të tjera që rregullojnë biznesin.

Kapitali rregjistruar i saj 15,000,000 lekë dhe aktualisht zotrohet nga Aksioneri i Vetem z.Klodjan Sula me 100 % te aksioneve të shoqërisë.

Objekti i këtij subjekti është :Tregtimi me shumice i lëndëve djegese të solarit, naftës, nënprodukteve përfshirë ato bio si dhe lëndet djegëse.

Adresa kryesore e ushtrimit te aktivitetit është Rruga Dibres, 462/2, pranë xhamisë Xhura, porcelan, kati i dytë (zyre kontabiliteti për nevojat e shoqerise) Tiranë.

Administrator i Shoqërisë është **Klodjan Sula**.

NIPT/NUIS: **L12805203J**.

Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës(sh.a. me dy nivele)

1. *Kujtim Nozllaku*
2. *Brunilda Balliu*
3. *Isuf Sula*

Numri mesatar i punonjësve: 8 punonjës

Referuar Nenit 4 të Ligjit 25/2018 dt.10.05.2019 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare "Trios" sh.a kategorizohet në: njësi ekonomike e vogël.

Pasqyrave Financiare janë hartuar sipas Standardeve Kontabël Kombëtare SKKP Nr.2, i ndryshuar.

Karakteristikat cilësore të pasqyrave financiare sipas SKKP Nr.1 janë:

- Parimin e paraqitjes me besnikeri;
 - Parimin e përparësisë së përmbajtjes ekonomike mbi formën ligjore.
 - Parimin e pa-anëshmërisë pa asnjë influencim të qëllimshëm;
 - Parimin e maturisë pa optimizem të tepruar, pa nën e mbivlerësim të qëllimshëm;
 - Parimin e plotësisë duke paraqitur një pamje të vërtetë e të drejtë të Pasqyrave Financiare;
 - Parimin e qëndrueshmërisë për të mos ndryshuar politikat e metodat kontabël;
 - Parimin e krahasueshmërisë duke siguruar krahasimin midis dy periudhave;
- Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj: 01.01.2019-31.12.2019.

A. Parimet bazë për përgatitjen e pasqyrave financiare

a) Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare(individuele) për qëllime të përgjithshme janë përgatitur dhe paraqiten në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit(SKK-të), të përmirësuar, dhe me kërkesat e Ligjit nr 25/2018, date 10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e vlerësimit të specifikuar nga SKKP për çdo klasë të aktiveve, detyrimeve, të performancës dhe ardhurave gjithpërfshirëse. Bazat e matjes përshkruhen në detaje në politikat kontabël të më poshtme. Sipas parimeve te kontabilitetit ne Shqipëri deklarimet financiare janë përgatitur mbi bazën e konceptit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Mbajtja e kontabilitetit, i cili përfshin si regjistrimet kontabël dhe sistemin e tij, mbahen në mënyrë të kompjuterizuar, me ane të një programi të kontabilitetit.

c) Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.



d) Krahasueshmëria

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabël të Shoqërisë dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas sistemit kontabël Shqiptar. Të dhënat krahasuese pasqyrojnë gjendjen e pozicionit financiar të shoqërisë në 31 Dhjetor 2019 [Ref. SKKP Nr.1].

e) Qëndrueshmëria e Paraqitjes

Një njësi ekonomike ruan paraqitjen dhe klasifikimin e zërave në pasqyrat financiare nga njëra periudhë në tjetrën.

f) Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë egzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar gjatë.

Zotëruesi ligjor dhe përfituesit e kapitalit aksioner të shoqërisë "Trios" shprehin gatishmërinë që shoqëria të plotësojë detyrimet e tyre financiare në çdo kohë dhe t'i sigurojnë asaj gjithë mbështetjen që mund të nevojitet për të mbajtur nivelin e kapitalit dhe likuiditetit në nivele të tilla që të përmbushin detyrimet e saj në përputhje me parimin e vijimësisë të përshtatshem për atë aktivitet që ajo kryen.

g) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKKP-t kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të jenë të ndryshme nga këto vlerësime. Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

▪ Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e klientëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të klientëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së klientëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

▪ Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

▪ Zhvlerësimi i inventarëve

Shoqëria vlerëson gjendjen e inventarit në qarkullim të ulët dhe inventarin i cili ka humbur vlerën e përdorimit për shkak të zhvillimeve teknologjike apo arsyeve të tjera, me synim për të përcaktuar masën e zhvlerësimit të inventarit, bazuar në përdorimin e ardhshëm të tij dhe në llogaritjen e vlerës neto të realizueshme. Në rast se vlera neto e realizueshme e inventarit është më e ulët se vlera kontabël neto, ekziston një tregues që inventari është i zhvlerësuar. Shoqëria përdor gjykimin e saj për të përcaktuar masën e zhvlerësimit.

B. Politikat kryesore kontabile

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.



1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës në të cilin është kryer transaksioni. Aktivet dhe pasivet monetare në monedhë të huaj në datën e mbylljes së bilancit janë rivlerësuar në monedhën funksionale sipas kursit të shpallur nga Banka e Shqipërisë në datën e mbylljes së periudhës ushtrimore. Diferencat që rrjedhin si rezultat i rikonvertimit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat kryesore të perdorura në konvertimin e gjendjeve të bilancit emërtuar në monedhe të huaj në datën e hartimit të bilancit janë si më poshtë (në LEK):

	<u>31.12.2019</u>	<u>31.12.2018</u>
Kurse e këmbimit		
Euro/Leke	121.77	123.42
USD/Leke	108.64	107.82
GBP/Leke	143.00	132.98

2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

▪ Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

▪ Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

▪ Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Per llogarite e pagueshme ,te pa paguara dhe te pa kërkuara per me shume se pese vjet per te cilat shoqëria bazuar ne te dhënat dhe komunikimin me palën tjetër nuk ka ndonjë pritshmëri per shlyerjen e këtyre detyrimeve, gjykon se detyrimet e me sipërme nuk duhen njohur si te tilla por i njeh si të ardhura te vitit qe vijne nga fshirja e tyre.



▪ **Hua të marra dhe të dhëna**

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

▪ **Vlera e drejtë**

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël, Shoqëria nuk ka aplikuar vlerë të drejtë.

▪ **Të tjera**

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

▪ **Zhvlerësime të aktiveve financiare**

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

▪ **Kapitali aksionar**

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale.

▪ **Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare**

Vlerat kontabile të aktiveve jofinanciare të shoqërisë, përveç inventarëve rishikohen në çdo datë raportimi për të parë nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabile e një aktiviteti është më e madhe se vlera e rikuperueshme e tij. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje.

Vlera e rikuperueshme e një aktiviteti është me e madhja mes vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së drejtë minus koston e shitjes. Në matjen e vlerës në përdorim, flukset e pritshme të parasë skontohen në vlerën e aktuale duke përdorur normën e skontimit përpara taksës që paraqet vlerësimin e tregut për vlerën në kohë të parasë dhe riskun specifik të aktivitetit.

Për humbjet nga zhvlerësimi të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohet në çdo datë raportimi nëse ka ndonjë tregues sipas të cilit humbja është ulur ose nuk ekziston më. Një humbje nga zhvlerësimi anulohet nëse kanë ndodhur ndryshimet në vlerësimet e bëra për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi anulohet deri në atë masë që vlera kontabël e aktiveve të mos kalojë vlerën kontabël të aktiveve, minus amortizimin, që do të ishte përcaktuar nëse zhvlerësimi nuk do të kishte ndodhur.



• **Ç`regjistrimi instrumentave financiare**

Aktivitet financiare së bashku me fondin rezervë të zhvlerësimit ç`regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitet.

Detyrimet financiare ç`regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë perfundojnë, skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

3. Aktivitet Afatgjate Materiale (AAM) dhe Jo materiale (AAJM)

▪ **Njohja dhe matja**

Të gjitha aktivitet afatgjate materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitet. Programi i blerë që është pjesë përbërëse në funksionimin e një pajisjeje është kapitalizuar si pjesë e pajisjes.

Në rastet kur pjesë të një aktivitet afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjate materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

• **Kostot e mëpasshme**

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjate materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjate materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

• **Amortizimi**

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitet afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitet.

Normat e amortizimit për vitin 2019 janë si më poshtë:

Kategoria e aktiveve Metoda e Amortizimit Norma e Amortizimit

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Toka	-	Nuk amortizohet
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Instalime Teknike	Vlera e mbetur	20%
Mobilje dhe orendi	Vlera e mbetur	20%
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Te tjera	Vlera e mbetur	20%

Vlera e mbartur e aktiveve afatgjate materiale rishikohen për zhvlerësim kur ngjarje apo ndryshime në rrethanat tregojnë se vlera kontabël mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë, kur vlera kontabël tejkalon vlerën e rikuperueshme të vlerësuar aktivitet paraqiten me vlerën e tyre të rikuperueshme, e cila



është më e larta mes vlerës së tyre të drejtë minus kostot për shitje dhe vlerës së tyre në përdorim.

Amortizimi nuk aplikohet për tokën dhe punimet në proces që nuk janë në funksionim.

- **Çregjistrimi**

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

Aktivët Afatgjata Jo-materiale (AAJM-t)

Një aktiv jo-material njihet nëqoftëse, e vetëm nëqoftëse: është e mundshme që përfitimet e pritshme ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij aktivi do të rrjedhin tek njësi ekonomike; dhe kosto e aktivit mund të matet me besueshmëri

Një njësi ekonomike vlerëson mundësinë e përfitimeve të pritshme ekonomike në të ardhmen duke përdorur supozime të arsyeshme dhe të mbështetura që përfaqësojnë vlerësimin më të mirë të drejtimit të kompletit të kushteve ekonomike që do të ekzistojnë gjatë jetës së dobishme të aktivit.

Njësi ekonomike përdor gjykimin për të vlerësuar shkallën e sigurisë bashkëngjitur flukseve të përfitimeve ekonomike në të ardhmen që i atribuohen përdorimit të aktivit mbi bazën e evidencës së disponueshme në kohën e njohjes fillestare, duke i dhënë më shumë rëndësi evidencës nga të tretët. Një aktiv jo-material matet fillimisht me koston.

- **Mbajtja e mëpasshme**

Mbas njohjes fillestare, një aktiv jo-material mbartet me koston e tij minus çdo amortizim të akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga zhvelërimi. Aktivët jo-materiale amortizohen me normën 15% mbi koston historike.

4. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

5. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate dhe të ardhura nga veprimtari të tjera jooperative.

6. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Pagesat e bëra për qiratë operative njihen në të ardhura ose shpenzime në mënyrë lineare gjatë afatit të qirasë.



7. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

8. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (2019: 15%).

9. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

10. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhur

11. Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

12. Krahasueshmëria e informacionit kontabel

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (rregullohen) në konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Ndryshimet janë kryer për të paraqitur më mirë natyrën e biznesit të Shoqërisë. Ato aplikohen retrospektivisht.



13. Mjetet Monetare

	31 Dhjetor 2019		31 Dhjetor 2018
	Monedha	Vlera në lekë	Vlera në lekë
Vlera monetare në lekë	Lekë	1.934.835	4.004.733
Banka EUR	Lekë	11.266	7.533.792
Vlera monetare në lekë	Lekë	-	-
Arka në EUR	Lekë	-	-
Totali		1.946.101	11.538.525

14. Llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme

	31 Dhjetor 2019		31 Dhjetor 2018
	Monedha	Vlera në lekë	Vlera në lekë
Nga aktiviteti i shfrytëzimit	Lekë	96.272.725	61.783.960
Te tjera	Lekë	-	4.558.963
Totali		96.272.725	66.342.923

15. Inventare

	31 Dhjetor 2019		31 Dhjetor 2018
	Monedha	Vlera në lekë	Vlera në lekë
Mallra	Lekë	19.467.602	31.603.534
Parapagime për inventar	Lekë	2.150.000	2.150.000
Totali		21.617.602	33.753.534

16. Shpenzime të shtyra

	31 Dhjetor 2019		31 Dhjetor 2018
	Monedha	Vlera në lekë	Vlera në lekë
Shpenzime të shtyra	Lekë	-	2.708.829
Totali		-	2.708.829

17. Aktive Afatgjata Materiale

	Toka	Nderrësa	Instalime teknike specifike	Mobilje dhe pasije	Pajisje informatike	Mjete Transporti	Total
Vlera bruto e AAM më 31.12.2018	10.240.000	2.686.605	84.120.081	401.690	1.339.803	7.562.848	106.351.027
Shtesa gjate 2019			2.384.634			9.826.853	12.211.487
AAM me 31 dhjetor 2018	10.240.000	2.686.605	86.504.715	401.690	1.339.803	17.389.701	118.562.514
Amortizimi i akumuluar më 31.12.2018	-	-	-	-	345.626	4.285.794	4.631.420
Amortizimi i vitit 2019		134.330	6.037.298	80.338	248.544	-	6.500.511
Amortizimi i akumuluar 31 dhjetor 2019	-	134.330	6.037.298	80.338	594.170	4.285.794	11.131.931
Vlera neto e AAM 2019	10.240.000	2.552.275	80.467.417	321.352	745.633	13.103.907	107.430.583
Vlera neto e AAM 2018	10.240.000	2.686.605	84.120.081	401.690	994.177	3.277.054	101.719.607

18. Detyrime ndaj institucioneve të kredise

Detyrime ndaj institucioneve të kredise

	31 Dhjetor 2019		31 Dhjetor 2018
	Monedha	Vlera në lekë	Vlera në lekë
Detyrime ndaj institucioneve të kredise	Lekë	1.267.239	-
Detyrime ndaj institucioneve të kredise	Lekë	3.935.634	-
AGJ	Lekë	-	-
Totali		5.202.873	-



19. Detyrime Afatshkurtra

		31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
	Monedha	Vlera në lekë	Vlera në lekë
Aktetime ne avance per porosi	Lekë	14.844.714	20.631.188
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	Lekë	67.540.036	92.002.010
Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shendetstore	Lekë	899.391	898.467
Te pagueshme per detyrime tatimore	Lekë	271.480	929.348
Te tjera te pagueshme	Lekë	93.123.645	54.050.387
Totali		176.679.265	168.511.400

20. Struktura e kapitalit

Ortaku i Vetëm	Numri i pjesëve (NR)	Vlera nominale e pjeses (Lekë)	Struktura e Kapitalit regjistruar (%)	Viti 2019
				Kapitali i Regjistruar (Lekë)
Klodjan Sula	7.500	2000	100%	15.000.000
				15.000.000

21. Të ardhura nga veprimtaria e shfrytëzimit

		31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
	Monedha	Vlera në lekë	Vlera në lekë
Te ardhurat nga aktiviteti kryesor	Lekë	271.468.330	242.254.397
Te tjera te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit	Lekë	761.476	1.787.023
Totali		272.229.806	244.041.420

22. Lenda e pare dhe materiale të konsumueshme

		31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
	Monedha	Vlera në lekë	Vlera në lekë
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme	Lekë	(237.214.909)	(231.273.829)
Totali		(237.214.909)	(231.273.829)

23. Shpenzime të personelit

		31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
	Monedha	Vlera në lekë	Vlera në lekë
Paga dhe shperblime	Lekë	(6.277.600)	(5.894.300)
Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetstore	Lekë	(924.122)	(825.420)
Totali		(7.201.722)	(6.719.720)

24. Shpenzime konsumi dhe amortizimi

		31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
	Monedha	Vlera në lekë	Vlera në lekë
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	Lekë	(6.500.511)	(779.506)
Totali		(6.500.511)	(779.506)



25. Shpenzime të tjera nga veprimtari e shfrytëzimit

Shpenzime të tjera shfrytëzimi

	31 Dhjetor 2019		31 Dhjetor 2018
	Monedha	Vlera në lekë	Vlera në lekë
Bl.energji,avull,uje	Lekë	398.255	361.845
Kancelari	Lekë	39.517	30.865
Blerje /shpenzime të tjera	Lekë	10.436	-
konsum nafte me tollon	Lekë	2.681.147	772.645
Trajtime të përgjithshme	Lekë	219.941	-
Qira	Lekë	414.000	414.000
Sherbime bashkepronie	Lekë	-	-
Mirembajtje dhe riparime	Lekë	1.663.525	-
kalibrim	Lekë	25.083	-
Sigurime	Lekë	622.461	-
sigurim mjete kasko	Lekë	313.798	-
Te tjera	Lekë	705.115	-
shpenzime për barren siguruese	Lekë	-	-
Sherbim zjarrefikes	Lekë	-	-
Kolaudim l boteve	Lekë	82.567	-
pashaporte autobotes	Lekë	-	-
shqyrtim dokumentacioni	Lekë	121.666	-
sherbim interneti	Lekë	50.790	-
shpenzime sgs cdo 6 mujor	Lekë	235.173	-
taksat e kamioneve trios	Lekë	283.044	-
Personel nga jashte ndermarjes	Lekë	-	-
noterizime dhe avokati	Lekë	20.000	31.900
objekti vaqar materiale dhe punime	Lekë	130.400	-
Sherbim kontabiliteti dhe auditimi	Lekë	225.000	240.000
		23.883	-
Sigurim oferte pjesemarrje ne te tender	Lekë	-	-
Shpenz për koncesione, patenta, licensa	Lekë	220.000	-
dhe të ngjashme			
marrje mostrash iqt	Lekë	385.000	-
kalibrimi vjetor objekti vaqar	Lekë	269.000	-
Publicitet, reklama	Lekë	-	-
Transferime, udhëtim, dieta	Lekë	-	-
Shpaz.postare e telekom.	Lekë	175.679	172.647
shpenzime parkimi pagese me tel	Lekë	20.040	-
Transporte për blerje	Lekë	30.220	-
Transporte për shitje	Lekë	61.793	-
Per personelin	Lekë	45.173	-
Sherbime bankare	Lekë	90.893	98.111
sherbime interneti	Lekë	12.500	-
shpenzime për goma kamionat	Lekë	921.802	-
Taksa dhe tarifa vendore	Lekë	202.000	207.000
taksa mjedisorë	Lekë	70.000	-
Taksa e regjistrimit	Lekë	148.080	-
Vlera kont. e AQ të shitura	Lekë	-	-
Gjoha dhe demshperblime	Lekë	364	4.533
Shpenzime për interesa	Lekë	-	-
Totali		10.918.344	2.333.545

Shënim:

Përshkrimi	2019	2018
Hartuesi i pasqyrave financiare	225,000	240,000
Auditues Ligjor	125,000	120,000



26. Shpenzime & ardhurat financiare

	31 Dhjetor 2019		31 Dhjetor 2018
	Monedha	Vlera në lekë	Vlera në lekë
Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme	Lekë	(229.410)	-
Shpenzime të tjera financiare	Lekë	-	9.401.077
Totali	Lekë	(229.410)	9.401.077

27. Rezultati Tatimor dhe Fitimi /(humbja) i vitit ushtrimor

	31 Dhjetor 2019		31 Dhjetor 2018
	Monedha	Vlera në lekë	Vlera në lekë
Fitimi/humbja para tatimit	Lekë	10.164.910	12.335.897
Shpenzime të panjohura	Lekë	-	-
Rezultati fiskal	Lekë	10.164.910	12.335.897
Tatim fitimi (15 %)	Lekë	(1.524.737)	(1.850.384)
Fitimi Neto		8.640.174	10.485.512

Per llogaritjen shpenzimeve per tatim fitimin jane mbajtur prasysh kriteret e percaktuara nga ligjit "Per tatimin mbi te ardhurat".

28. Palët e lidhura

Te drejte dhe detyrime	Viti -2019		Viti -2018	
	Të arketueshme	Të Pagueshme	Të arketueshme	Të Pagueshme
Detyrime ndaj Aksionerit	-	48.268.335	-	19.400.472
Detyrime ndaj Aksionerit	-	16.228.717	-	17.878.117
Detyrime ndaj Aksionerit	-	2.112.140	-	2.112.140
Detyrime ndaj Aksionerit	-	10.076.550	-	9.926.550
Dividende per tu paguar	-	14.530.343	-	3.069.608
	-	-	-	2.708.829
	-	91.216.085	-	49.677.998

Transaksione	Viti -2019		Viti -2018	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
	-	-	-	-

29. Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

• Çështje gjyqësore

Më 31 Dhjetor 2019 Shoqëria/subjekti nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

• Detyrime tatimore

Librat e Shoqërisë/subjektit nuk janë audituar nga organet tatimore për periudhën 2019. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.


• Ngjarje pas datës së bilancit

- Gjatë fillimit të Marsit 2020, shfaqja e Covid-19 në Shqipëri, ka krijuar vështirësi në funksionimin e bizneseve në Shqipëri për shkak të masave të marra

nga Qeveria Shqiptare për parandalimin e përhapjes së këtij virusi. Kjo ngjarje ka një ndikim të menjëhershëm në shumë hallka të zinxhirit ekonomik. Deri në datën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare kjo ngjarje është konsideruar si ngjarje jo me efekte rregulluese për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019.

Nuk ka ngjarje të tjera mbas datës së raportimit të cilat mund të kërkojnë rregullime apo paraqitje të informacionit në pasqyrat financiare të njësisë Ekonomike.


Hartues i Pasqyrave Financiare



Ermir Veipi



Administrator



Klodjan Sula

